

K O N T R A T E

PER THEMELIMIN E SHOQERISE ANONIME

“TELEVIZIONI ARBERIA” “ T V A ”

Neni 1 : Aksioneret

Aksioneret themelues te shoqerise “ Televizioni Arberia ” SH.A jane :

1. **Ardian Takaj**,lindur me 05.04.1963 ne Tirane,banues ne Yzberisht Tirane,me nr.0329105 pasaporte .
2. **Roke Koro**,lindur me 13.12.1961 ne Tirane,banues ne Yzberisht Tirane,me nr.0547933 pasaporte .
3. **Perikli Karavella**,lindur me 26.12.1956 ne Kavaje,banues ne Rr. “Xhorxh Bajron” nr.54/4, Laprake Tirane,me Nr.0263078 pasaporte .

Neni 2 : Emertimi

Shoqeria emertohet “Televizioni Arberia”me emer te shkurtuar T V A. Shoqeria eshte pa oferte publike.

Neni 3 : Selia

Shoqeria e ka seline ne qytetin e Tiranës ne rrugen e Kavajes nr.34/1 Tirane .

Neni 4 : Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet prej 2.000.000 (dy milion) leke me vleren e nje aksioni 1000 lek,me ndarje si me poshte :



Takaj	zoteron	40% te kapitalit ose	800 aksione .
Koro	zoteron	40% te kapitalit ose	800 aksione .
Perikli Karavella	zoteron	20% te kapitalit ose	400 aksione .

Neni 5 : Objekti

Objekti i veprimtarise te shoqerise eshte veprimtaria televizive. Shoqeria brenda kufijve te parashikuara ne legjislacionin ne fuqi do te kryeje cdo veprimtari, qe lidhet direkt ose indirekt me objektin e veprimtarise te saj .

Shoqeria mund te hape edhe veprimtari te reja, te krijojte shoqeri te reja ose te marre pjese ne shoqeri te tjera, si brenda ashtu edhe jashte vendit, gjithmone ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .

Neni 6 : Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj me afat te pacaktuar. Afati minimal i veprimtarise te shoqerise eshte jo me pak se 30 vjet , duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit , Tirane .

Neni 7 : Organet

Organet e shoqerise jane :

1. Asambleja e Aksionereve
2. Keshilli Mbikqyres
3. Drejtoria (Drejtori i Pergjithshem)

Rregullat e funksionimit te ketyre organeve parashikohen ne statutin e shoqerise

Themeluesit e shoqerise per drejtimin e saj, ne **Keshillin Mbikqyres** caktuan zoterinjte: 1. **Ardian Takaj**, lindur me 05.04. me 13.12.1961, ne Tirane, banues ne Yzberisht Tirane . 2. **Roke Koro**, lindur me 13.12.1961 ne Tirane banues ne Yzberisht Tirane. 3. **Bardhyl Martiniani**, lindur me 02.08.1941 ne Tirane, banues ne rrugen "K.Cipo" P.6 shk.5 ap.49 Tirane .

Drejtor te Pergjithshem caktuan z. **Perikli Karavella**, lindur me 26.12.1956 ne Kavaje banues ne rrugen "Xhorxh Bajron" nr.54/4 Laprake Tirane.

Ekspert kontabel te autoeizuar caktuan z. **Etem Sulaj**, lindur ne vitin 1960 ne Fier, banues ne Tirane te re, te blloku i vilave.

Detyrimet e Ortakeve

fillimin e veprimtarise te shoqerise,pas rregjistrimit ne gjykate, ortaket themelues Ardian Takaj dhe Roke Koro bashkerisht marin persiper detyrimin qe te kalojne ne favor te saj, fonde te nevojshme ,makineri e paisje,mjete e materjale te ndryshme te televizionit eksperimental,sipas listes me vleren perkatese,qe do te depozitohet ne seline e shoqeris

Neni 10 : Zgjidhja e Mosmarveshjeve

Organi kopotent per zgjidhjen e mosmarveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Tirane,ne qofte se mosmarveshjet nuk mbyllen paraprakisht me pajtim .

Neni 11 : Kontrata

Kontrata hartohet ne 5 kopje origjinale.Kjo Kontrate dhe Statuti qe i bashkelidhet si pjese perberse e saj,jane dokumentet baze te themelimit te shoqerise .

Neni 12 : Nenshkrimi i Kontrates

Kjo kontrate hyn ne fuqi me nenshkrimin e saj,se bashku me statutin, para noterit, prej aksionereve themelues,sot ne daten 02.10.1999 ne Tirane .

AKSIONERET THEMELUES**1. ARDIAN TAKAJ**

2. ROKE KORO

3. PERIKLI KARAVELLA

PERIKLI KARAVELLA



S T A T U T

I SHOQERISE ANONIME (SH.A.)

“TELEVIZIONI ARBERIA” T V A

Ne mbështetje të ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 “Per Shoqerite Tregtare” aksioneret themelues të nënshkruarit :

1. **Ardian Takaj**,lindur me 05.04.1963 ne Tirane,banues ne Yzberisht Tirane,me Nr.0329105 pasaporte .
2. **Roke Koro**,lindur me 13.12.1961 ne Tirane,banues ne Yzberisht Tirane,me Nr.0547933 pasaporte .
3. **Perikli Karavella**,lindur me 25.12.1956 ne Kavaje,banues ne Rr “Xhorxh Bajron”Nr.54/4 Laprake,Tirane,me Nr.0263078 pasaporte .

hartuan statutin e shoqerise anonime “T.V.A” me permbajtjen qe vijon :

NENI 1 : Emri

Shoqeria emertohet “TELEVIZIONI ARBERIA” me emer te shkurtuar “T.V.A”.Ne te gjitha aktet dhe dokumentet qe do te nxiren nga shoqeria,emertimi i saj do te pasohet nga inicjalet SH.A dhe nga shpallja e kapitalit themeltar .

NENI 2 : Forma

Midis themeluesve te shoqerise qe jane pronare te aksioneve,eshte krijuar nje shoqeri anonime pa oferte publike,qe rregullohet sipas ligjit “Per Shoqerite Tregtare” dhe nga ky statut .

NENI 3 : Personaliteti Juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik,qe nga dita e fregjistrimit te saj ne fregjistrin tregtar te gjykates se rrethit Tirane .

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionon shqiptar ne fuqi,si dhe ne dispozitat e parashikuara ne aktet e themelimit qe jane kontrata dhe sttuti i shoqerise .

NENI 4 : Selia

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane ne rrugen e “Kavajes” Nr.34/1 Tirane .Selia e shoqerise mund te transferohet ne nje vend tjeter me vendimin e Asamblese se Aksionereve .

Kohezgjatja

do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje kohe te pakufizuar,por gjithmone jo me 30 vjet nga data e regjistrimit te saj ne gjykatën e rrethit Tirane .
 kurtimi i afatit minimal te veprimtarise te shoqerise,behet me vendim te Asamblese te jashtezakonshme te Aksionereve .

NENI 6 : Objekti i Veprimtarise

Objekti i veprimtarise te shoqerise eshte veprimtaria televizive.

Shoqeria brenda kufijve te parashikuar ne legjislacionin ne fuqi do te kryeje cdo veprimtari qe lidhet direkt ose indirekt me objektin e veprimtarise se saj .

Shoqeria mund te hape edhe veprimtari te reja.Ajo mund te krijojë shoqeri te reja,ose te marre pjese ne shoqeri te tjera,si brenda ashtu dhe jashte vendit,pa cenuar objektin e veprimtarise se saj,por gjithmone ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .

NENI 7 : Kapitali Themeltar dhe Kontributet

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2.000.000 leke.Ky kapital eshte i ndare ne 2.000 aksione,secili me vlere nominale 1.000 (njemije)lek .

Pronesia e aksioneve per secilin aksioner themelues i shoqerise eshte :

- | | | |
|----------------------|---------|------------------------------------|
| 1. Ardian Takaj | zoteron | 40% te kapitalit ose 800 aksione . |
| 2. Roke Koro | zoteron | 40% te kapitalit ose 800 aksione . |
| 3. Perikli Karavella | zoteron | 20% te kapitalit ose 400 aksione . |

Kontributet ne para te aksionereve themelues te shoqerise qe u pergjigjen vleres nominale te aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise,jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht prej tyre .

Shuma e kapitalit themeltar (themeltar) e derdhur nga aksioneret eshte depozituar rregullisht,ne nje llogari te hapur ne banke,ose te noteri.Derdhjet jane vertetuar nga nje certifikate e hartuar sipas ligjit .

NENI 8 : Ndryshimi i Kapitalit Themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet emetimit te aksioneve te reja,ose nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve egzistuese .

Organi kopetent qe vendos per zmadhimin e kapitalit eshte Asamblea e Jashtezakonshme e Aksionereve.

Rregulla te hollësishme per proceduren,menyren dhe modalitetet e nevojshme qe duhen kryer per zmadhimin e kapitalit themeltar parashikohen ne nenet 150 deri 163 te ligjit "Per Shoqerite Tregtare" .

Kapitali i shoqerise mund te zvogelohet.Ne te gjitha rastet zvogelimi i kapitalit behet ne te njejten mase ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoterojne .Organi kopetent qe vendos per zvogelimin e kapitalit themeltar eshte Asamblea e Jashtezakonshme e Aksionereve .

Transferimi i Pronesise te Aksioneve

shoqerise jane te transferueshme. Transferimi i pronesise te aksioneve me perjashtim te rasteve te trashegimit, behet pasi te jete marre miratim me shkrim nga Keshilli Mbikqyres .

Miratimi i transferimit konsiderohet i dhene nepermjet nje njoftimi ose kur nuk jepet pergjigje brenda nje afati prej tre muaj nga data e paraqitjes se kerkeses nga aksioneri per transferimin e pronesise te aksioneve .

Ne qofte se nuk jepet miratimi, shoqeria brenda tre muajve nga data e mosdhenies se miratimit, detyrohet te bleje aksionet nepermjet nje aksioneri ose personi te trete. Ne qofte se pas kalimit te ketij afati, blerja nuk eshte realizuar, miratimi per transferimin e pronesise se aksioneve konsiderohet i dhene .

NENI 10 : Te Drejtat e Detyrat te Lidhura me Aksioneret

Cdo aksioner i jep te drejten zoteruesit te tij per marrjen e pjeses perkatese nga fitimet e shoqerise ne perpjestim me kuoten e pjeses te kapitalit qe ai perfaqeson .

Aksioni i jep zoteruesit te tij te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamblene sipas kushteve te percaktuara ne ligj dhe ne kete statut .

Cdo aksioner jep gjithashtu te drejten e pjeses ne aktivin e mbetur, pas shlyerjes te kreditorve, ne rastin e nje likuidimi te shoqerise .

Aksioneret jane pergjegjes deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne .

Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet i ndjekin ato ne cdo forme qe aksionet transferohen nga njera dore ne tjetren .

Aksionet jane te pandashme kundrejt shoqerise. Bashkepronaret e aksioneve, paraqiten ne shoqeri nepermjet perfaqesuesit caktuar per tyre .

NENI 11 : Organet e Shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

Asambleja e Aksionereve, e Zakonshme dhe e Jashtzakonshme
Keshilli Mbikqyres
Drejtoria (Drejtori i Pergjithshem) .

NENI 12 : Rregulla te Perbashketa per Asamblete e Aksionereve

- a- Asamblete e pergjithshme te aksionereve cilesohen te zakonshme ose te jashtzakonshme sipas natyres se vendimeve per te cilat ato jane thirrur qe te marrin. Cdo Asamble perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote. Vendimet e Asamblese se Pergjithshme detyrojne te gjitha anetaret, pavaresisht ne votojne kunder apo mungojne .
- b- Asamblete e pergjithshme te aksionereve thirren nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres, nga jo me pak se dy anetare te ketij Keshilli ose nga Drejtori i Pergjithshem. Asamblete e Pergjithshme mblidhen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te treguar ne thirrjen qe i dergohet cdo aksioneri 15 dite perpara mbledhjes, qe permban rendin e dites .

aksioner ka te drejte te asistojne ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme dhe ne vendimet e saj, personalisht ose nepermjet nje perfaqesuesi te pajisur me pasacem e ne kushtet e parashikuara nga ligji .
 Mbledhjet e Asamblese drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose, ne te tij, nga antar i Keshillit i caktuar nga Kryetari. Drejtuesi i mbledhjes cakton edhe sekretar (qe mund te jete aksioner) per te mbajtur procesverbalin. Procesverbali pervec te grave permban edhe :

- Datën dhe vendin e mbledhjes
- Numrin e aksionereve te pranishem dhe quorumin e arritur
- Drejtuesin e mbledhjes
- Rendin e dites
- Dokumentat e raportet qe jane diskutuar
- Nje permbledhje e debateve
- Rezultatet e votimeve

Procesverbalet e mbledhjeve rruhen ne seline e shoqerise .

e- Ne Asamblene e Pergjithshme quorumi llogaritet per teresine e aksioneve, qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise .E drejta e votes qe u perket aksionereve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne.Cdo aksioner i jep te drejten zoteruesit te drejten e nje vote.Votimi kryhet i vecante per cdo ceshtje apo vendim .

f- Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe afatet e parashikuara ne ligj, dokumentat e llogarive vjetore qe shqyrton Asambleja .

NENI 13 : Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme

Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar. Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhje vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar, zoterojne jo me pak se 2/3 te numrit te pergjithshem te aksioneve. Asambleja e Zakonshme merr vendime me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar. Vendimet e Asamblese se Zakonshme mund te jene edhe qarkullues. Per te realizuar kete lloj vendimi perfundimtar shperndahet projekti, mblidhen verejtjet dhe me pas firmoset vendimi perfundimtar pa u mbledhur aksioneret fizikisht ne ndonje salle .

Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme merr cdo vendim, qe nuk sjell ndryshimin e statutit te shoqerise. Ajo ka keto kompetenca :

- Miraton politiken e pergjithshme (strategjine afatgjate te zhvillimit te shoqerise)
- Miraton plan-biznesin dhe planin financiar vjetor
- Miraton, ndryshon, hedh poshte llogarite vjetore qe jane shtruar per miratim
- Vendors per shperndarjen e fitimit dhe destinimin e rezultatit ekonomik ne pajtim me ligjet dhe statutin
- Emeron dhe shkarkon Kryetarin dhe antaret e Keshillit Mbikqyres, si dhe cakton shperblimet e parashikuara per ta
- Miraton ose jo emerimet e antareve te Keshillit Mbikqyres, te bera nga vete ky Keshill, si emerime te perkoheshme
- Shkarkon, me propozimin e Keshillit Mbikqyres, antaret e Drejtorise (perfshire edhe Drejtorin e Pergjithshem)
- Miraton pjesmarjen ne sipermarje te tjera, brenda ose jashte vendit





jo, ndryshimin e selise se shoqerise
 ekspertin(ose ekspertin kontabel)te autorizuar dhe vendos per raportin e paraqitur

14 : Asambleja e Pergjithshme e Jashtzakonshme

Asambleja e Pergjithshme e Jashtzakonshme mblidhet me kerkesen e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres,ose jo me pak se dy anetare te ketij Keshilli,ose te aksionereve qe zoterojne jo me pak se 1/4 e aksioneve te shoqerise .

Asambleja e Jashtzakonshme mund te marre vendime te vlefshme kur aksioneret e pranishem zoterojne jo me pak se 2/3 e aksioneve te shoqerise .

Vendimet e Asamblese se Pergjithshme merren me shumicen prej 3/4 te votave qe u perkasin aksionereve te pranishem .

Asambleja e Jashtzakonshme ka keto kopetenca :

- Te ndryshoje Statutin e Shoqerise
- Te vendose zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit ne baze te procedurave te parashikuara ne ligj dhe raportit te paraqitur Keshillit Mbikqyres
- Te vendose per prishjen(shperndarjen)e shoqerise ne rast te humbjeve te konstatuara,sipas kushteve dhe procedurave te parashikuara ne ligj
- Te ndryshoje kopetencat e Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorise (Drejtorit te Pergjithshem)

Per mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme te Jashtzakonshme mbahet procesverbal dhe materialet rruhen ne arkivin e shoqerise .

NENI 15 : Keshilli Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjidhet nga Asambleja e Zakonshme e shoqerise ne cdo 3 vjet.Ai ne fillim te veprimtarise do te perbehet nga tre anetare,njeri prej te cileve eshte Kryetar.Te gjithë anetaret e Keshillit Mbikqyres jane aksionere te shoqerise (ose duhet te behen te tille brenda nje viti nga dita e zgjedhjes).

Aneteret e Keshillit Mbikqyres jane persona fizike ose juridike,qe nuk duhet te jene punesuar ne shoqeri.Ne rastin kur nje anetar i Keshillit Mbikqyres eshte nje person juridik,ai duhet te caktojë nje perfaqesues te perhershëm .

Nese nje ose disa vende te anetareve te Keshillit Mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje,shkarkimi ose dorheqje,zevendesimi i tyre behet jo me vone se tre muaj.Anetari i emeruar ne zevendesim te nje anetari tjetër perfundon mandatin e paraardhësit .

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres behen me thirrjen e Kryetarit sa here qe e kerkon interesi i shoqerise dhe te pakten nje here ne tre muaj.Mbledhjet mbahen ne seline e shoqerise dhe rendi i dites caktohet nga Kryetari .

Cdo Antar i keshillit Mbikqyres mund ti jape mandat te ri nje antari tjetër per ta perfaqesuar ne nje mbledhje te Keshillit .

Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres jane te vlefshme kur numri i anetareve te pranishem ne mbledhje eshte jo me pak se gjysma e anetareve ne funksion .

Vendimet merren me shumicen e votave te anetareve te pranishem dhe te perfaqesuar.Ne rast votash te barabarte ajo e Kryetarit eshte percaktuese.Ne rastin e zgjedhjes ose shkarkimit te Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise,kerkohet edhe vota e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres .

vendimet e Keshillit Mbikqyres pasqyrohen ne procesverbalet, te cilat nga drejtuesi i mbledhjes dhe ruhen ne arkivin e shoqerise .

Keshillit Mbikqyres mund te jene edhe qarkullues. Per te realizuar projektin, mblidhen verejtjet dhe me pas firmoset vendimi perfundimtar pa u anetaret fizikisht ne ndonje salle .

Keshilli Mbikqyres ka vulen e vet me te cilen vulosen aktet e nxjera prej tij .
Keshilli Mbikqyres ka keto kopetenca :

- Ushtron kontroll te perhershem per drejtimin e shoqerise nga ana e administrates te saj
- Miraton strukturen organizative te shoqerise dhe ndryshimet e saj, kriteret e punesimit dhe te pagave, si dhe rregulloren e brendshme te shoqerise .
- Autorizon dhenien e dorzaneve ose te garancive .
- Autorizon kryerjen e investimeve tej atyre te parashikuara ne programin financiar vjetor .
- Autorizon hapjen e veprimtarive te reja, ose ndarjen e bashkimit e veprimtarive te shoqerise .
- Autorizon pjesmarjen ne shoqeri te tjera, si dhe shitjen ose shkembimin e pasurive qe perbejne pjesen aktive te qendrueshme te shoqerise .
- Autorizon negociimin, lidhjen ose ndryshimin e kontratave per nje shume mbi dy milion lek ose ekuivalencen e saj ne valute. Kufiri i kesaj shume caktohet per cdo vit .
- Kryen kontrollin e nevojshem mbi aktivitetin e Drejtorise duke patur te drejte te njihet mbi te gjitha dokumentacionin e Drejtorise. Ne cdo tre muaj therret ne raport Drejtorin e Pergjithshem.
- Miraton bilancin vjetor dhe ja paraqet Asamblese se Zakonshme .
- Miraton transferimin e aksioneve dhe praktiket e marketingut .
- Miraton strukturen baze te tarifave baze te sherbimeve .
- Therret dhe drejton mbledhjet e Asamblese .
- Vendos per transferimin e selise se shoqerise .
- Zgjedh Drejtorin e Pergjithshem dhe Drejtoret e tjere, me votat e jo me pak se tre anetareve, nje prej te cileve duhet te jete Kryetari i Keshillit .

NENI 16 : Drejtoria

Drejtoria eshte organi ekzekutiv i shoqerise. Ne perjudhen fillestare te shoqerise detyrat e Drejtorise i kryen Drejtori i Pergjithshem, i cili ne menyren nominative eshte caktuar ne kontraten e themelimit te kesaj shoqerie te ciles i bashkelidhet ky Statut .

Drejtori i Pergjithshem, si dhe Drejtori zgjidhen per nje perjudhe tre vjecare. Ata mund te shkarkohen para afatit per paaftesi profesionale, ose per shkak te gjendjes shendetsore qe sjell paaftesi ne kryerjen e detyres, ose per gabime te renda ne drejtimin e shoqerise .

Drejtori i Pergjithshem, si dhe Drejtoret nuk mund te bejne pjese ne Keshillin Mbikqyres te Shoqerise, por mund te jene aksionere te saj .

Masa dhe menyra e shperblimit te Drejtorit te Pergjithshem ose te Drejtoresve caktohet nga Keshilli Mbikqyres qe me aktin e emerimit te tyre .

Drejtori i Pergjithshem eshte pergjegjes per drejtimin e shoqerise si dhe per administrimin e pasurise se saj. Ai zbaton metodat qe i cmon me te pershtatshme per te realizuar detyrat e caktuara nga Asambleja e Ortakeve ose Keshilli Mbikqyres. Drejtori i Pergjithshem ushtron kopetencat e veta brenda objektit te veprimtarise se shoqerise. Ne marredheniet me te tretet ai perfaqeson shoqerine .

perdor vulen e Shoqerise. Te gjitha aktet qe nxjerr drejtori i
 shprehur prej tij, vulosen dhe pasi protokollohen rruhen ne arkivin e saj .

Pergjithshem ka keto kompetenca :

• Miraton vendime ose akte te tjera per miratimin ne Keshillin Mbikqyres ose ne
 Komitetin e Aksionereve .

• Miraton thirrjen e Asamblese se Aksionereve kur Keshilli Mbikqyres refuzon dhenien e
 autorizimive perkatese per kryerjen e operacioneve te nevojshme per acurine dhe
 shpallurvatjen e shoqerise .

• Emeron dhe shkarkon shefat e sektoreve dhe personelin tjeter administrativ, si dhe
 percakton pagat e tyre .

• Miraton kontraten tip te punes dhe ate me abonentet .

• Merr vendime per marredheniet financiare brenda shoqerise dhe per marredheniet
 financiare me persona te trete jashte saj .

• Merr vendime per zgjidhje te karakterit teknik .

• Cakton shperblime te vecanta dhe honorare per punonjes te vecante te shoqerise ose per
 persona te tjere jashte saj .

Ne cdo rast Drejtori i Pergjithshem eshte i detyruar te raportoje per veprimtarine e tij ne
 pergjithsi ose per probleme te vecanta, para Asamblese te Aksionereve (Kur kete e kerkojne
 aksioneret qe zoterojne jo me pak se 1/5 te kapitalit te shoqerise), si dhe para Keshillit
 Mbikqyres (Kur kete e kerkojne Kryetari dhe jo me pak se tre anetare te ketij Keshilli) .

Drejtori i Pergjithshem mund te krijojte Keshillin Operativ si organ ndihmes te tij per
 administrimin e shoqerise .

Drejtori i Pergjithshem ka te drejte te delegoje nje pjese te kompetencave te tij tek organet
 ose personat qe i ka ne vartesi .

NENI 17 : Keshilli Operativ Teknik

Keshilli Operativ Teknik eshte nje organ konsultativ i Drejtorit te Pergjithshem, ne te cilin
 Drejtori ka cilesine e Kryetarit dhe keshilltaret e shefat e sektoreve jane anetare .

Keshilli Operativ Teknik mblidhet me kerkesen e Drejtorit te Pergjithshem, ose te jo me pak
 se dy anetareve .

Keshilli Operativ Teknik nuk merr vendime, por ne lidhje me problemet e drejtimit dhe
 administrimit te shoqerise ndihmon Drejtorin e Pergjithshem per kordinomin e punes midis
 sektoreve, si dhe problemet e shfrytezimit te rrjetit ose te zgjerimit te tij .

Propozimet e ketij Keshilli miratohen me shumice votash .

Per anetaret e Keshillit Operativ nuk parashikohet shperblim i vecante pervec rasteve kur ata
 ngarkohen per te kryer studime e per te hartuar projekte qe tejkalojne detyrat e punes
 normale te tyre .

NENI 18 : Marreveshjet e Ndaluar dhe Marreveshjet qe Kerkojne Autorizim

Anetaret e Keshillit Mbikqyres dhe te Drejtorise (Drejtori i Pergjithshem) u ndalohej qe te
 kontraktojne, qe te marrin hua nga shoqeria, tu akordohen llogari rrjedhese ose ne nje forme
 tjeter, dhe te bejne shoqerine dorezenese apo garante per detyrimet e tyre ndaj te treteve .

Cdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe njerit nga anetaret e Keshillit Mbikqyres ose
 Drejtorise (Drejtorit te Pergjithshem), qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi (me

duhet te autorizohet paraprakisht nga Keshilli Mbikqyres (nga Kryetari, apo nga tre anetare te ketij Keshilli).

KONTABILITETI DHE FINANCAT E SHOQERISE

NENI 19 : Aftesia Pague

Shoqeria krijon marzhin e aftesise pague te mjaftueshme per veprimtarine e saj, duke perfshire te gjitha vleren e pasurive, si kapitalin themeltar, rezervat, fitimet e mbartura etj.

NENI 20 : Veprimtaria Financiare

Veprimtaria financiare fillon ne 1 janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen dhe daten e regjistrimit ne Regjistrin Tregetar deri ne 31 dhjetor.

NENI 21 : Bilanci Vjetor

Shoqeria mund te mbaje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat e ligjit. Per ndjekjen e gjendjes financiare Drejtori i Pergjithshem, sipas struktures dhe permbajtjes te percaktuar ne planin kontabel, pergatit raportin mbi gjendjen financiare cdo tre mujor si dhe ate vjetor.

Ne mbylljen e cdo viti financiar hartohet inventari i pasurise dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore per kontabilitetin, si dhe raporti vjetor mbi gjendjen financiare te shoqerise gjate ushtrimit te veprimtarise, ku parashikohen dhe ndryshime per te ardhmen e veprimtarite e tjera te shoqerise.

Keto te dhena i jepen Ekspertit Kontabel nje muaj perpara mbledhjes se Asamblese se Aksionereve, i cili ben komentet e veta ne nje raport te vecante.

NENI 22 : Miratimi i Bilancit

Raporti per gjendjen financiare te shoqerise, i detajuar per te gjitha operacionet dhe per gjendjen e administrimit te shoqerise paraqitet nga Drejtori i Pergjithshem ne fund te vitit financiar ne Keshillin Mbikqyres, i cili e miraton dhe ja paraqet Asamblese se Zakonshme te aksionereve.

NENI 23 : Rezultati i Veprimtarise Financiare dhe Rezervat

Rezultati i veprimtarise financiare percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit te veprimtarise.

Nga fitimi i realizuar hiqet te pakten 5% per te krijuar rezerven e detyrueshme. Heqja e fitimit per rezerven e detyrueshme pushon se qeni kur kjo rezerve arrin 15% te kapitalit themeltar. Asambleja e Zakonshme, ne rast nevojje, mund te formoje dhe fonde te tjera. Shuma e fitimeve te mbetura pas krijimit te rezervave, si me siper perfaqeson dividendin.

Shoqeria ka llogarite e saj bankare dhe pergjigjet me fondet e saj per taksat dhe detyrimet e tjera ndaj Shtetit .

NENI 24 : Pergjegjesite ndaj Shtetit

Shoqeria ka llogarite e saj bankare dhe pergjigjet me fondet e saj per taksat dhe detyrimet e tjera ndaj Shtetit .

NENI 25 : Ekspertet Kontabel

Kontrolli financiar ushtrohet nga nje ose disa Eksperte te autorizuar te licensuar konform legjislacionit shqiptar, te cilet emerohen nga Asambleja e Zakonshme dhe kryejne misjonin e tyre ne pajtim me ligjin .

Ekspertet kontabel jane te autorizuar qe ne cdo kohe te vitit se bashku ose vec e vec, te bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe gjykohen te domosdoshme dhe mund te shfrytezojne te gjitha dokumentacionin e vleresuar si te dobishem ne ushtrimin e funksionit te tyre, ne vecanti, kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrin e procesverbaleve .

Detyrat dhe te drejtat e eksperteve kontabel te pavarur te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji "Per shoqerite tregtare" .

Ekspertet kontabel informojne Keshillin Mbikqyres dhe Drejtorin e Pergjithshem per :

1. Kontrollet, verifikimet dhe sondazhet qe kane kryer .
2. Pjeset e bilancit dhe te dokumenteve te tjera te kontabilitetit ku ata kane verejtje .
3. Parregullsite dhe pasaktesite qe kane zbuluar .

Ekspertet kontabel thirren ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres kur mbyllen llogarite e vitit financiar si dhe ne mbledhjen e Asamblese. Ata jane pergjegjes si ndaj shoqerise, ashtu edhe ndaj te treteve, per pasojat qe rrjedhin prej fajit te tyre gjate ushtrimit te funksioneve qe kane . Honoraret e eksperteve i ngarkohen shoqerise. Keshilli Mbikqyres me rastin e miratimit te eksperteve, miraton dhe masen e shperblimit te tyre .

Marendheniet e eksperteve kontabel me shoqerine percaktohen ne nje kontrate midis tyre dhe Drejtorit te Pergjithshem .

Neni 26 : Likujdimi

Shperndarja e shoqerise , mund te behet ne cdo kohe, kur per shkaqe te ndryshme nuk mund te vazhdoje aktivitetin e saj. Ne kete rast ajo vihet ne likujdim .

Likujdimi behet ne pajtim me dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit "Per proceduren e falimentimit" .

Asambleja e Jashtzakonshme e aksionereve cakton likuidatoret duke percaktuar edhe kompetencat qe ata kane .

RREGULLIMI I SHOQERISE

Neni 27 : Ndryshimi i kapitalit themeltar

Ndryshimet e kapitalit themeltar, zmadhimi ose zvogelimi i tij, si dhe menytrat e realizimit te tyre, do te percaktohen konform dispozitave te ligjit Nr.7638 date 19.11.1993 "Per Shoqerite Tregtare" dhe te akteve te tjera ligjore ne fuqi .

E Drejta e Komunikimit dhe Informimit

aksioner ka te drejten e komunikimit e te informimit te vazhdueshem .
 mbledhjes se cdo asambleje ose konsulte,cdo aksioner ka te drejten e njohjes se
 dokumentacionit e te informacioneve te tjera qe lidhen me problemet qe do te diskutohen ose
 konsultohen.Keto do ti vihen ne dispozicion aksionerit ne kushtet e percaktuara ne dispozitat
 ligjore dhe rregulloret ne fuqi .

Neni 29 : Fshehtesia e Informacionit

Te gjithe aksioneret,anetaret e Keshillit Mbikqyres,Drejtoret(Drejtori i Pergjithshem)dhe te punesuarit e tjere te shoqerise jane te deyruar te truajne fshehtesine e cdo informacioni te dhene ne lidhje direkte ose indirekte me shoqerine per te cilat ata vihen ne dijeni gjate ushtrimit te aktivitetit te tyre ose ne menyre te terthorte.Ata duhet te marrin te gjitha masat e nevojshme dhe te zbatojne proceduret e percaktuara per te penguar perhapjen ne cfardo lloj forme te informacionit .

Te gjithe aksioneret,anetaret e Keshillit Mbikqyres Drejtoret(Drejtori i Pergjithshem)dhe te punesuarit e tjere pergjigjen per pasojat e demshme qe i shkaktohen shoqerise nga perhapja e pa autorizuar e informacionit .

Neni 30 : Marredheniet me Punonjesit

Marredheniet e shoqerise me punonjesit rregullohen sipas legjislacionit mbi Marredheniet e Punes ne Republiken e Shqiperise .

Neni 31 : Falimentimi,Paaftesia ose Vdekja e nje Aksioneri

Shoqeria nuk prishet kur falimenton,vdes ose shfaq paaftesi fizike apo mendore njeri nga aksioneret .

Neni 32 : Vula

Shoqeria ka vulen e vet qe permban,emrin e shoqerise dhe adresen e selise se saj .

Neni 33 : Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet midis aksionereve,te punesuarve dhe personave te trete ne rast se zgjidhja nuk arrihet me mirkuptim (Konsensus) ajo behet objekt i gjykates kompetente .

Neni 34 : Rastet e Paparashikuara

Rastet e paparashikuara ne kete statut do te trajtohen e rregullohen sipas dispozitave te ligjit Nr . 7638 date 19.11.1993 "Per Shoqerite Tregetare" dhe te akteve te tjera ligjore qe jane ne fuqi .





Kopjet dhe Nenshkrimi i Statutit

eshte hartuar ne kater kopje origjinale ne gjuhen shqipe dhe me vlere te
statut nenshkruhet rregullisht prej aksionereve themelues te shoqerise ne Tirane sot
daten 02.10.1999 .

AKSIONERET THEMELUES

ARDIAN TAKAJ

ROKE KORO

PERIKLI KARAVELLA

REP E SHOQERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1448 Rep.Nr. 120 Kol.VERTETIM

Sot me daten 02.10.1999 ne Zyren e Noterise Tirane,para meje Noterit u paraqiten personalisht themeluesit e shoqerise anonime "Televizioni Arberia"SH.A me emer te shkurtuar "T V A",Zoterinjte Ardian Takaj,Roke Koro dhe Perikli Karavella,madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,te cilet deklaruan se Kontraten dhe Statutin e themelimit te Shoqerise "T V A" e kane hartuar jashte kesaj zyre dhe me vullnetin e tyre te lire e te plote e firmosen para meje noterit dhe une i vertetoj ne perputhje me ligjin .

NOTER

HYSEN SENA

